



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

Nr.54, Datë 29.01.2020

**PËR
CAKTIMIN NË POZICION TË GJYQTARIT TË EMËRUAR Z.SHKËLZEN LIÇAJ**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në pikën 1, të nenit 147/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në pikën 3, të nenit 39, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në shkronjën “b”, të nenit 86, në pikën 1, të nenit 97 dhe në nenin 100, të Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në konsideratë të Vendimit të Këshillit nr.11, datë 09.01.2020, “Për emërimin gjyqtar të z.Shkëlzen Liçaj”, si dhe në renditjen e gjyqtarëve të emëruar në listën e të diplomuarve të miratuar nga Shkolla e Magjistraturës, mbi propozimin e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës,

VENDOSI:

1. Gjyqtari i emëruar z. Shkëlzen Liçaj caktohet në pozicion pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë.
2. Efektet juridike të vendimit fillojnë nga data e njoftimit të tij.
3. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtarit z. Shkëlzen Liçaj sipas kërkesave të shkronjës “c”, pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, në adresën postare elektronike të depozituar zyrtarisht pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR